



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në përputhje me nenin 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 7, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, 1.4, nenin 30 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenin 14 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L – 054 për Gjykatat, Rregulloren (09/2016) mbi Procedurat e Zgjedhjes, Emërimit, Vlerësimit, Pezullimit dhe Shkarkimit të Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës të ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren 14/2016, Rregulloren 17/2016, Rregulloren 05/2017 si dhe Rregulloren Nr. 01/2020, si dhe Vendimit KGJK Nr. 267/2021 të datës 7 Tetor 2021, shpall:

**RISHPALL KONKURSIN PËR KRYETAR TË
GJYKATËS THEMELORE PRIZREN**

1. Gjykata Themelore në Prizren – Kryetar i Gjykatës;

KRITERET

1. Për kandidat për kryetar të gjykatës mund të aplikojë vetëm gjyqtari që vije nga radhët e asaj gjykate përkatëse duke përfshirë dhe degët.
2. Kandidati për kryetar të gjykatës duhet të plotësoj kriteret themelore si në vijim:
 - 2.1. të ketë të paktën tri (3) vite përvojë pune si gjyqtar, si dhe
 - 2.2. të mos ketë sanksion disiplinor me vendim të formës së prerë, përjashtimisht nëse ndaj tij është shqiptuar masa e qortimit ose vërejtjes jo-publike, në pesë vitet e fundit.
3. Kandidati për kryetar të gjykatës përveç profesionalizmit dhe kualifikimeve për kryerjen e funksionit, duhet të ketë aftësi dhe njohuri në kryerjen e punëve të udhëheqjes dhe organizimit brenda gjykatës si dhe integritet personal, që nënkuptojnë:
 - 3.1 Njohjen e punëve të administratës gjyqësore;
 - 3.2 Reputacionin të cilin kandidati gëzon nga ana e kolegëve gjyqtarë;
 - 3.3 Komunikimin korrekt me palë dhe kolegë brenda gjykatës;
 - 3.4 Gatishmërinë për bashkëpunim me organizata dhe institucione tjera;
 - 3.5 Të qenurit kreativ në punë duke lehtësuar kështu punën e gjykatës.
4. Vlerësimi i aftësive nga paragrafi 3. i këtij neni bëhet edhe përmes intervistës me kandidatin për kryetar të gjykatës.

5. Këshilli Gjyqësor i Kosovës do të merr në konsideratë trajnimet e specializuara, përvojën menaxheriale dhe vlerësimin e performancës të kandidatit për kryetar të gjykatës.
6. Të drejtë për aplikim nuk kanë:
 - 6.1 Anëtari i Këshillit Gjyqësor të Kosovës,
 - 6.2 Kryetari i gjykatës apo gjyqtari mbikqyrës i cili ka përfunduar mandatin e tij si kryetar gjykate apo gjyqtar mbikqyrës; si dhe
 - 6.3 Gjyqtarët të cilët nuk i përmbushin kriteret sipas legjislacionit në fuqi.

FORMULARI I APLIKIMIT

- formularin mund ta shkarkojnë në Ueb faqen e KGJK-së. (www.gjyqesori-rks.org)

[Shkarko Aplikacionin](#)

AFATI I DORËZIMIT TË APLIKACIONEVE

Data e fillimit të aplikimi: 11 Tetor 2021

Data e fundit të aplikimit: 25 Tetor 2021

Formularët për aplikim dorëzohen, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga publikimi i konkursit në:

Sekretariatit e KGJK-së, Rruga ‘Luan Haradinaj’ nr. 133, Prishtinë në Zyrën e Pranimit.

RREGULLAT DHE PROCEDURAT

Kandidatëve që aplikojnë për pozitën përkatëse do t`ju kërkohen dokumente të ndryshme për të mbështetur aplikacionin e tyre. Lidhur me këtë çështje, secili kandidat do të kontaktohet individualisht dhe përmes e -mail adresave për t`ju dërguar formularët dhe detajet për procedurat e mëtutjeshme.